

FOL

Udhë pa Krye

Monitorimi i
ndërtimit të Autostradës
Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë

Udhë pa Krye

Ky projekt u financua nga granti i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Opinonet, gjetjet dhe përfundimet e shprehura në këtë raport janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e KFOS-it



Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje	4
Metodologjia	6
Procesi i prokurimit	7
Planifikimi i prokurimit.....	7
Njoftimi për kontratë.....	7
Procesverbali i hapjes së tenderit.....	7
Nënshkrimi i kontratave.....	8
Procesi i shpronësimit dhe vlerësimi i pronës së paluajtshme	9
Procesi i shpronësimit.....	9
Vendimi preliminar.....	9
Vendimi përfundimtar.....	9
Parcelat e shpronësuara.....	10
Vlerësimi i pronës së paluajtshme.....	12
Kalimi i pronësisë nga një pronar në një tjetër në komunat e Lipjanit dhe Gjilanit.....	12
Komuna e Lipjanit.....	13
Ndërrimi i pronarëve të parcelave gjatë vitit 2016.....	14
Ndërrimi i pronarëve të parcelave gjatë vitit 2017.....	15
Ndërrimi i pronarëve të parcelave gjatë periudhës janar-nëntor 2018.....	15
Komuna e Gjilanit.....	16
Dëgjimet publike	18
Monitorimi i punimeve në terren	20
Komunikimi me institucionet	22
Përfundime	24

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AK - Autoriteti Kontraktues

ASHMDHP - Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

DSH - Departamenti i Shpronësimit

DTP - Departamenti i Tatimit në Pronë

IAP - Institucioni i Avokatit të Popullit

KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

MF - Ministria e Financave

MI - Ministria e Infrastrukturës

OP - Operator Ekonomik

OSHP - Organi Shqyrtues i Prokurimit

ZVPP - Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme

Përmbledhje

Raporti "Udhë pa krye" paraqet gjetjet nga monitorimin i njërës prej kontratave më të mëdha të nënshkruara nga Ministria e Infrastrukturës. E nënshkruar në muajin shkurt të vitit 2018, kjo kontratë është karakterizuar me parregullësi të shumëta, mungesë të transparencës gjatë dhënies së kontratës, për tu ndjekuar nga po e njejta edhe gjatë implementimit, pra ndërtimit të autostradës. Marrë parasysh vlerën e lartë të parave që janë marrë nga buxheti i shtetit për të ndërtuar këtë autostradë, Lëvizja FOL ka monitoruar procesin e prokurimit të kontratës 88-milionëshe dhe procesin e shpronësimit që detyrimisht rezulton nga ndërtimi i autostradës.

FOL e ka parë si të domosdoshme që të bëhet një monitorim i tillë me qëllim të rritjes së transparencës në lidhje me shpenzimin e parasë publike në prokurimin publik, procesin e shpronësimit dhe vlerësimit të pronës së paluajtshme, dëgjimet publike si dhe monitorimin e punimeve në terren.

Monitorimi 6-mujor i realizuar nga Lëvizja FOL në terren dhe analizimi i dokumenteve të dhëna nga Ministria e Infrastrukturës ka gjetur:

- Ndonëse vlera e kontratës për ndërtimin e autostradës tejkalon 80 milionë euro, Ministria e Infrastrukturës nuk ka dhënë qasje në planin e prokurimit të vitit 2018 për të parë nëse kjo kontratë ka qenë e planifikuar në planin përfundimtar të prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës;
- Ministria e Infrastrukturës ka dështuar në ofrimin e planit të menaxhimit të kontratës, dokument i cili do të mundësonte monitorimin e procesit në tërësi;
- Dispozitat kontraktuese nuk janë respektuar nga operatorët ekonomikë. Punimet në terren kanë filluar me vonesë edhe përkundër përcaktimeve në dispozitat kontraktuese. Kontratat e nënshkruara në mesin e muajit shkurt 2018 kanë përcaktuar që punimet duhet të fillojnë pesë ditë pas nënshkrimit të të njëjtave, megjithatë punimet në terren, në pjesën më të madhe të tyre, kanë filluar me disa muaj vonesë si rezultat i mungesës së shpronësimit dhe kushteve atmosferike.
- Procesi i shpronësimit dhe vlerësimit të pronës së paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të ligjeve në fuqi dhe është treguar i mbyllur për publikun. Procesi i shpronësimit ka vazhduar, në një pjesë nga ku kalon traseja e ndërtimit të autostradës, vetëm pas nënshkrimit të kontratave me operatorët ekonomikë dhe pas fillimit të punimeve në terren për ndërtimin e autostradës;
- Vendimet e Qeverisë për shpronësimin e paluajtshmërive në zonën ku kalon traseja e autostradës kanë dalluar mes veti. Përderisa në vendimin preliminar kanë qenë të përfshira 4 komuna dhe 10 zona kadastrale, vendimi përfundimtar i Qeverisë nuk ka përfshirë 2 komuna dhe 3 zona kadastrale për shkak të mospërfundimit të vlerësimit të pronave ku kalon traseja.

- Procedurat ligjore i kanë dhënë hapësirë Komunave të Lipjanit dhe Gjilanit që të mundësojnë ndërrimin e pronarëve të pronave të paluajtshme gjatë gjithë procesit, deri në miratimin e vendimit përfundimtar nga ana e Qeverisë. Kjo lë vend për shitblerje të dyshimta të të njëjtave prona, sidomos kur e kemi parasysh faktin e mungesës së të dhënave mbi vlerësimin financiar të të njëjtave prona nga ana institucioneve vendore.
- Në kuadër të vlerësimit të pronës së paluajtshme, Ministria e Financave nuk është treguar e gatshme t'i ofrojë Lëvizjes FOL shumat financiare të këtij vlerësimi. Ministria e Financave, duke u thirrur në sigurinë publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale ka refuzuar që t'i ofrojë këto të dhëna, edhe përkundër faktit që pronarët dhe zotëruesit e interesit do të kompensohen nga buxheti i Republikës së Kosovës;
- Në zonat kadastrale të Komunës së Lipjanit gjatë viteve 2016, 2017 dhe periudhës janar-nëntor 2018, janë proceduar 395 lëndë për ndërrim të pronarit, në kuadër të shitblerjeve, trashëgimisë, përfitimit në formë dhurate apo vendimeve nga gjykata.
- Në zonat kadastrale të Komunës së Gjilanit gjatë periudhës janar-nëntor 2018, janë proceduar 270 lëndë për ndërrim të pronarit, në kuadër të shitblerjeve, trashëgimisë, përfitimit në formë dhurate apo vendimeve nga gjykata.
- Qytetarët kanë qenë shumë pak të informuar për procesin e shpronësimit apo projektin në tërësi. Dëgjimet publike lidhur me procesin e shpronësimit janë mbajtur në katër komunat të cilat preken nga ky proces, megjithatë pjesëmarrja e qytetarëve, apo të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, ka qenë shumë e ulët krahasuar me rëndësinë e projektit. Përveç pjesëmarrjes së ulët, qytetarët e pranishëm nuk kanë qenë të njoftuar më herët mbi detajet e projektit, kalimin e trasesë, vijën e shpronësimit, si dhe kanë hasur në probleme me kategorizimin e pronave të tyre dhe dokumentacionin mbi pronësinë.

Metodologjia

Në kuadër të monitorimit të ndërtimit të autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë, Lëvizja FOL ka vlerësuar procedurën e prokurimit publik në bazë të së cilës janë rekomanduar operatorët ekonomikë të cilët, në një moment të dytë kohor, i kanë nënshkruar kontratat me Ministrinë e Infrastrukturës si autoritet kontraktues. Vlerësimi është bërë duke u bazuar në një pjesë të dokumenteve të ofruara nga Ministria e Infrastrukturës, si dhe nga monitorimi dhe vlerësimi i dokumenteve nga ueb-faqet e E-Prokurimit, Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit¹.

Procesi i shpronësimit dhe vlerësimi i pronës së paluajtshme është bërë duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe Ligjin 03/L-205 i cili plotëson dhe ndryshon Ligjin 03/L-139 në disa pjesë. Në të njëjtën kohë, procesi i shpronësimit është vlerësuar bazuar edhe në vendimet qeveritare të miratuara nga Qeveria në kuadër të këtij procesi, si dhe është bashkëpunuar me Departamentin e Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Për të pasur një vlerësim sa më të mirëfilltë, Lëvizja FOL ka bashkëpunuar edhe me dy, nga katër komunat, e prekura nga procesi i shpronësimit, gjegjësisht atë të Lipjanit dhe Gjilanit.

Në monitorimin e procesit të vlerësimit të pronës së paluajtshme janë kontaktuar institucionet publike, gjegjësisht Ministria e Financave e cila ka të themeluar Departamentin e Tatimit në Pronë së bashku me Zyrën për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, përgjegjëse për vlerësimin e pronës së paluajtshme.

Dëgjimet publike janë monitoruar duke u bazuar në procesverbalet e përpiluara nga Departamenti i Shpronësimit, pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila i ka organizuar debatet në katër komunat e prekura nga procesi i shpronësimit.

Gjatë zhvillimit të punimeve, për të pasur një pasqyrë sa më të qartë të kalimit të trasesë, pengesave me të cilën përballen operatorët ekonomikë, si dhe progresit të punimeve, Lëvizja FOL ka monitoruar punimet në të gjithë trasenë ku do të ndërtohet autostrada. Ky monitorim ka vazhduar për një muaj dhe janë vizituar ato pjesë ku operatorët ekonomikë e kanë pasur të mundur të fillojnë punimet.

¹ Një vlerësim më gjithëpërfshirës i procedurave të prokurimit është paraqitur në tryezën e organizuar nga Lëvizja FOL me datë 15 nëntor 2018.

Procesi i prokurimit

Vlerësimi i procedurave të prokurimit, në këtë pjesë të raportit, është bërë në kuadër të: 1. Planifikimit të prokurimit; 2. Njoftimit për kontratë; 3. Procesverbalit të hapjes së tenderit; dhe 4. Nënshkrimit të kontratave.

1. Planifikimi i prokurimit

Për të kuptuar saktë se kur ishte planifikuar ndërtimi i kësaj autostrade FOL ka kërkuar qasje në planifikimin e prokurimit duke iu referuar Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, me qëllimi që të dokumentohet nëse ndërtimi i kësaj autostrade ishte planifikuar në planin përfundimtar të prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës. Ministria e Infrastrukturës nuk ka ofruar qasje, me arsyetimin e zyrtarit aktual se në atë periudhë kohore nuk ishte i emëruar në këtë pozitë dhe nuk ka njohuri se ku mund të jenë planet e prokurimit të viteve të kaluara.

2. Njoftimi për kontratë

Njoftimi për kontratë për projektin ‘Ndërtimi i Auto udhës A7.1 - Kryqëzimi në disnivel A6/A7.1(Banullë) - Dheu i Bardhë - Pjesa: Kryqëzimi Në Disnivel A6/A7.1(Banullë) - Udhëkryqi “Bresallc ”- L=22.31km” është bërë publik në E-Prokurim me datë 12.06.2017, ndërkaq kompanitë kanë pasur mundësi që të ofertojnë deri me datë 21.07.2017.

3. Procesverbali hapjes së tenderit

Gjatë vlerësimit të procesverbaleve (Procesverbali i Hapjes dhe E-Prokurimit), të bazuara në dosjen e ofruar nga Ministria e Infrastrukturës, FOL ka gjetur se procesverbali i Hapjes dhe ai i E-Prokurimit nuk janë të njëjtë. Në procesverbalin e Ministrisë së Infrastrukturës janë të regjistruara vetëm 15 kompani, ndërkaq në Procesverbalin e Hapjes, ku janë të nënshkruar të gjithë Operatorët Ekonomikë, ofertues kanë qenë 27 kompani/konzorciume konkurruese.

Nga 27 Operatorë Ekonomikë sa kishin dorëzuar dosjen e tenderit për projektin ‘Ndërtimi i Auto udhës A7.1 - Kryqëzimi në disnivel A6/A7.1(Banullë) - Dheu i Bardhë - Pjesa: Kryqëzimi Në Disnivel A6/A7.1(Banullë) - Udhëkryqi “Bresalc”- L=22.31km”, 24 Operatorë Ekonomik kishin konkurruar si konzorciume, ndërkaq si Operatorë Ekonomik individual ka pasur vetëm 3.

**Kompanitë ofertuese të
rekomanduara nga Komisioni
Vlerësues për dhënie të
kontratës**

	Çmimi i Kontratës	LOTI
Granit & Ingeniering & Armendi	18,468,426.58 €	I
GP & Papenburg&Adriani	5,906,293.67 €	II
Ndertimtari & Geci	6,850,467.72 €	III
2 A Group & Alkoimpex & Ex -Fis & 2 T	8,700,127.36	IV
Ekavatori & ABAD (ABISC)	17,899,684.83 €	V
Kag asphalt & Beni com	11,633,267.01 €	VI
Al Trade & Salillari	7,247,086.87 €	VII
Base Joos Krasniqi & Pevlaku	11,913,157.91 €	VIII

Numri i kompanive tenderuese	Konzorciume	Operatorë Individualë	Ekonomikë	Operatorë fitues
27 Ofertues	24	3		8

4. Nënshkrimi i Kontratave

Autoriteti Kontraktues i ka nënshkruar kontratat me tetë Operatorë Ekonomikë në kuadër të zhvillimit të projektit “Ndërtimi i autoudhës A7.1-Kryqezimi me disnivel A6/A7.1 (Banulle)-Dheu I Bardhe-pjesa: Kryqëzimi ne disnivel A6/A7.1 (Banulle)-Udhëkryqi Bresalc-L22.31km”.

Projekti i ndërtimit të kësaj autostradë është ndarë në tetë Lote dhe arrin shifrën prej **88,618,511.95 €**. Gjatësia e trasesë është **22,485 m**.

Kontratat janë nënshkruar gjatë muajit shkurt 2018, dhe të gjitha kontrata kanë kohëzgjatje për përfundimin e punimeve prej 30 muajve.

Procesi i Shpronësimit dhe Vlerësimi i Pronës së Paluajtshme

1. Procesi i Shpronësimit

Ministria e Infrastrukturës, si organ e cila ka paraqitur kërkesën për shpronësim, ka nënshkruar kontratat me operatorët ekonomikë pa filluar ende procesi i shpronësimit². Qeveria, në kuadër të miratimit të kërkesës për shpronësim, është bazuar në normat Kushtetuese të Republikës së Kosovës, rregullore të veçanta, përfshirë këtu Ligjin nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme³. Qeveria megjithatë, edhe pse është thirrur në nenin 4 të Ligjit nr.03/L-139, nuk e ka respektuar të njëjtin, i cili nen, në paragrafin 1.2., përcakton se: Qëllimi i ligjshëm publik (shih. ndërtimi i autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë), nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e shpronësimit.

Procesi i deritanishëm i shpronësimit, i cili ka kaluar përmes miratimit të disa vendimeve qeveritare, ka qenë i pjesshëm. Qeveria, në kuadër të shpronësimit ka miratuar dy vendime: 1. Vendimin Preliminar; dhe 2. Vendimin Përfundimtar.

1.1. Vendimi Preliminar⁴

Qeveria, në kuadër të vendimit preliminar, ka përfshirë të gjitha zonat kadastrale të katër komunave ku kalon traseja e autostradës. Gjegjësisht, në këtë vendim janë përfshirë komunat dhe zonat kadastrale në vijim:

- 1.1.1. Komuna e Lipjanit - Zonat Kadastrale: Banullë, Smallushë, Sllovi;
- 1.1.2. Komuna e Graçanicës - Zona Kadastrale: Dobratin;
- 1.1.3. Komuna e Novobërdës - Zonat Kadastrale: Kufcë e Epër, Koretishë, Parollovë;
- 1.1.4. Komuna e Gjilanit - Zonat Kadastrale: Bresalc, Ponesh, Zhegovc.

² Ministria e Infrastrukturës ka nënshkruar kontratat me operatorët ekonomikë në muajin Shkurt 2018, kurse Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 11.05.2018, ka miratuar për shqyrtim të mëtutjeshëm kërkesën e organit shpronësues për shpronësim për interes publik të pronave dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit të autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë.

³ Ligji nr.03/L-139 është ndryshuar dhe plotësuar në disa pjesë nga nr.03/L-205.

⁴ Vendimi Preliminar është miratuare me datë 28.08.2018.

1.2. Vendimi Përfundimtar⁵

Në vendimin përfundimtar, ku paraqitet mos përfundimi në tërësi i procesit të shpronësimit, nuk janë të përfshira të gjitha zonat kadastrale sikur në vendimin preliminar.

Në vendimin përfundimtar, si rezultat i mos përfundimit të procesit të vlerësimit të pronave ku kalon traseja, nuk janë të përfshira këto zona kadastrale:

1.2.1. Komuna e Graçanicës - Zona Kadastrale: Dobratin;

1.2.2. Komuna e Novobërdës - Zonat Kadastrale: Kufcë e Epër dhe Koretishë.

Megjithatë, Ligji nr. 03/L-205 dhe Ligji nr. 03/L-139, në nenin 11, paragrafi 1 dhe 3, i japin të drejtën Organit Shpronësues (i.e Qeverisë) që brenda afatit 12 mujor, i cili fillon 15 ditë pas hyrjes në fuqi të Vendimit Preliminar, të marrë vendim përfundimtar për miratimin ose refuzimin plotësisht ose pjesërisht të kërkesës për shpronësim. Të njëjtit paragrafë ia mundësojnë Organit Shpronësues që brenda së quajturës “Periudhë Përfundimtare e Vendosjes” të miratojë Vendime të tjera Përfundimtare lidhur me pronën ose të drejtat të cilat kanë qenë objekt i ankesës, nëse këto Vendime Përfundimtare janë në përputhje me aktgjykimin ose urdhrin përkatës gjyqësor të nxjerrë në përputhje me nenin 35 të këtij ligji.

1.3. Parcelat e shpronësuara

Me Vendimin Përfundimtar Qeveria ka miratuar shpronësimin e një sipërfaqeje terreni prej 1.931462 km² në kuadër të shpronësimit për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë⁶.

Numri i përgjithshëm i parcelave të prekura nga shpronësimi është 763⁷. Sipërfaqet e shpronësuara kanë qenë të kategorive/pronësive shoqërore, private, komunale dhe të kompanive.

⁵ Vendimi Përfundimtar është miratuar me datë 23.10.2018. Të dhënat mbi parcelat e shpronësuara janë marrë nga Vendim Përfundimtar.

⁶ Sipërfaqja e shpronësuar në metra katrorë është 1,931462, megjithatë për të thjeshtësuar të dhënat e raportit në këtë rast janë shënuar shumat në kilometra katrorë.


⁷ Sqarim: Parcelat në këtë rast paraqesin numrin e pronave të cilat janë prekur nga shpronësimi. Megjithatë kjo nuk do të thotë se e gjithë parcela është shpronësuar. Në pjesën më të madhe të rasteve vetëm një

Në kategorinë me pronësi shoqërore janë shpronësuar 832,020 m² me gjithsej 117 parcela të prekura nga shpronësimi.

Në kategorinë me pronësi private është shpronësuar sipërfaqja më e madhe me gjithsej 1.061006 km² dhe 634 parcela të prekura nga shpronësimi.

Në kategorinë me pronësi komunale janë shpronësuar gjithsej 12,792 m² me 7 parcela të prekura nga ky shpronësim.

Kategoria e sipërfaqeve të shpronësuar, me pronësi të kompanive, ka arritur në gjithsej në 25,644 m² me 5 parcela të prekura nga procesi i shpronësimit.



Graf. 1. Ndarja sipas përqindjeve e kategorive pronësore të cilat janë shpronësuar.

Mbetet të vlerësohet nëse Qeveria do të procedojë, sipas Vendimit Preliminar, me vlerësimin dhe shpronësimin e sipërfaqeve në zonat kadastrale të Dobratinit (Komuna e Graçanicës dhe Koretishës dhe Kufcës së Epërme (Komuna e Lipjanit).

Megjithatë, procedurat ligjore i kanë dhënë hapësirë Komunave të Lipjanit dhe Gjilanit që të mundësojnë ndërrimin e pronarëve të pronave të paluajtshme gjatë gjithë procesit, deri në miratimin e vendimit përfundimtar nga ana e Qeverisë. E njëjta procedurë do t'i mundësonte edhe Komunave të Novobërdës dhe Graçanicës lejimin e ndërrimit të pronarëve të pronave të paluajtshme deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Qeverisë për shpronësimin e zonave kadastrale të këtyre komunave ku është paraparë të kalojë traseja e ndërtimit të autostradës.

sipërfaqe e parcelës është shpronësuar, gjegjësisht ajo pjesë mbi të cilën është paraparë të kalojë autostrada.

Mundësia e ndërrimit të pronarëve të pronave të paluajtshme, që nga momenti i fillimit të procedurave të dëgjimeve publike deri tek miratimi i vendimeve përfundimtare nga ana e Qeverisë, lë vend për shitblerje të dyshimta të të njëjtave prona, sidomos kur e kemi parasysh faktin e mungesës së të dhënave mbi vlerësimin financiar të të njëjtave prona nga ana institucioneve vendore.

2. Vlerësimi i Pronës së Paluajtshme

Vlerësimi i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, si një proces i cili duhet t'i paraprijë procesit përfundimtar të shpronësimit, nuk ka përfunduar ende. Siç është thënë më lart, mos përmbyllja e procesit të shpronësimit është i ndërlidhur në pjesën më të madhe me mungesën e vlerësimit të pronës së paluajtshme. Zonat kadastrale, të cilat deri në këtë kohë nuk kanë kaluar në procesin e vlerësimit janë Kufca e Epër dhe Koretisha (Komuna e Novobërdës) dhe Dobatini (Komuna e Graçanicës).

Parcelat e shpronësuara, sipas Vendimit Përfundimtar të Qeverisë, janë vlerësuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme e cila themelohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave⁸. Megjithatë, e njëjta ministri ka refuzuar t'i ofrojë Lëvizjes FOL të dhëna mbi shumat financiare përmes së cilave është paraparë të kompensohen pronarët dhe zotëruesit e interesit të pronave private të patundshme si rezultat i procesit të shpronësimit. Ministria e Financave ka kthyer përgjigje negative në kërkesën për qasje në dokumente publike, duke theksuar se është e pamundur të ofrohen të dhënat e kërkuara nga Lëvizja FOL, ngase të njëjtat përjashtohen nga e drejta e qasjes në dokumente, sipas Ligjit nr. 03/L-215, neni 12, paragrafi 1.2. mbi sigurinë publike dhe paragrafi 1.6. mbi privatësinë dhe interesat e tjerë legjitim privat.

Si rezultat i kësaj, Lëvizja FOL e ka pasur të pamundur të vlerësojë shumat financiare të cilat janë paguar nga buxheti publik për shpronësimin e pronave private të patundshme të pronarëve apo zotëruesve interesit.

2.1. Kalimi i pronësisë nga një pronar në një tjetër në komunat e Lipjanit dhe Gjilanit

⁸ Sipas Ligjit nr. 03/L-130 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, neni 21, paragrafi 1, Ministria e Ekonomisë dhe Financave (i.e. Ministria e Financave), në kuadër të Departamentit për Tatim në Pronë, do të themelojë Zyren për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme.

Lëvizja FOL, në kuadër të procesit të vlerësimit të pronave private të paluajtshme, gjegjësisht të ndërrimit të pronarëve në parcelat e zonave kadastrale ku kalon traseja e autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë, ka kontaktuar me zyrtarët komunalë nga Komunitat e Lipjanit dhe Gjilanit, dy nga katër komunitat e përfshira në procesin e shpronësimit, ku janë kërkuar të dhëna për vitet 2016, 2017 dhe 2018 mbi:

1. Numrin e parcelave me pronësi private të prekura nga procesin i shpronësimit;
2. Sa nga këto parcela kanë pësuar ndryshim të pronarit sipas Regjistrave mbi të Drejtat e Pronave të Paluajtshme;
3. Kur është bërë kalimi i parcelave të lartpërmendura (muaji dhe viti) për herë të fundit nga një pronar në tjetrin, në rast se ka pasur kalim pronësie.

2.1.1. Komuna e Lipjanit


Komuna e Lipjanit i ka ofruar të dhënat e kërkuara për të tri vitet dhe tri zonat kadastrale, atë të Banullës, Smallushës dhe Sllovisë. Sipas Komunitës së Lipjanit, gjatë viteve 2016, 2017 dhe periudhës janar-nëntor 2018, janë proceduar 395 lëndë për ndërrim të pronarit, në kuadër të shitblerjeve, trashëgimisë, përfitimit në formë dhurate apo vendimeve nga gjykata.

Numri më i madh i ndërrimit të pronarëve të parcelave, gjatë kësaj periudhe, ka qenë në kategorinë e shitblerjes me gjithsej 161 lëndë të proceduara. Në këtë kategori zona kadastrale të Sllovisë ka pasur më së shumti lëndë të proceduara me gjithsej 27 parcela të cilave iu janë ndërruar pronarët.


Në kategorinë e dhënies së pronës si dhuratë janë proceduar gjithsej 112 lëndë, me zonën kadastrale të Sllovisë me numrin më të madh prej gjithsej 48 lëndësh.

Në kategorinë e trashëgimisë janë proceduar gjithsej 94 lëndë, ku numri më i madh ka rezultuar në zonën kadastrale të Sllovisë me gjithsej 44 lëndë.

Kategoria e fundit, kalimi i pronësisë nga një pronar në tjetrin, ka qenë kategoria me më së paku lëndë të proceduara, gjithsej 28, ku zona kadastrale e Sllovisë ka pasur numrin më të lartë të këtyre lëndëve me gjithsej 12.



Graf. 2. Ndarja sipas numrit e lëndëve të proceduara nga Komuna e Lipjanit mbi ndërrimin e pronarëve nga parcelat e zonave kadastrale Banullë, Smallushë, Sllovi, të cilat përfshijnë vitet 2016, 2017 dhe periudhën janar-nëntor 2018.




Graf. 3. Ndarja sipas përqindjeve e lëndëve të proceduara nga Komuna e Lipjanit mbi ndërrimin e pronarëve nga parcelat e zonave kadastrale Banullë, Smallushë, Sllovi, të cilat përfshijnë vitet 2016, 2017 dhe periudhën janar-nëntor 2018.

2.1.1.1. Ndërrimi i pronarëve të parcelave gjatë vitit 2016

Sipas Komunës së Lipjanit, gjatë vitit 2016 janë proceduar 126 lëndë për ndërrim të pronarit, në kuadër të shitblerjeve, trashëgimisë, përfitimit në formë dhurate apo vendimeve nga gjykata.

Numri më i madh i ndërrimit të pronarëve të parcelave, gjatë vitit 2016, ka qenë në kategorinë e shitblerjes me gjithsej 56 lëndë të proceduara. Në këtë kategori, zona kadastrale të Sllovisë ka pasur më së shumti lëndë të proceduara me gjithsej 27 parcela të cilave iu janë ndërruar pronarët.




Graf. 4. Ndarja sipas numrit e lëndëve të proceduara nga Komuna e Lipjanit mbi ndërrimin e pronarëve nga parcelat e zonave kadastrale Banullë, Smallushë, Sllovi të cilat përfshijnë vitin 2016.

2.1.1.2. Ndërrimi i pronarëve të parcelave gjatë vitit 2017

Gjithnjë sipas Komunës së Lipjanit, gjatë vitit 2017 janë proceduar 95 lëndë për ndërrim të pronarit, në kuadër të shitblerjeve, trashëgimisë, përfitimit në formë dhurate apo vendimeve nga gjykata.

Numri më i madh i ndërrimit të pronarëve të parcelave, gjatë vitit 2017, ka qenë në kategorinë e shitblerjes me gjithsej 32 lëndë të proceduara. Në këtë kategori, zona kadastrale të Smallushës ka pasur më së shumti lëndë të proceduara me gjithsej 15 parcela të cilave iu janë ndërruar pronarët.




Graf. 5. Ndarja sipas numrit e lëndëve të proceduara nga Komuna e Lipjanit mbi ndërrimin e pronarëve nga parcelat e zonave kadastrale Banullë, Smallushë, Sllovi të cilat përfshijnë vitin 2017.

2.1.1.3. Ndërrimi i pronarëve të parcelave gjatë periudhës janar-nëntor 2018

Gjatë periudhës 01 janar 2018 - 21 nëntor 2018, Komuna e Lipjanit ka proceduar 174 lëndë për ndërrim të pronarit, në kuadër të shitblerjeve, trashëgimisë, përfitimit në formë dhurate apo vendimeve nga gjykata.

Numri më i madh i ndërrimit të pronarëve të parcelave, gjatë kësaj periudhe, ka qenë në kategorinë e shitblerjes me gjithsej 73 lëndë të proceduara. Në këtë kategori, zona kadastrale të Sllovisë ka pasur më së shumti lëndë të proceduara me gjithsej 40 parcela të cilave iu janë ndërruar pronarët.



Graf. 6. Ndarja sipas numrit e lëndëve të proceduara nga Komuna e Lipjanit mbi ndërrimin e pronarëve nga parcelat e zonave kadastrale Banullë, Smallushë, Sllovi të cilat përfshijnë periudhën janar-nëntor 2018.

2.1.2. Komuna e Gjilanit

Komuna e Gjilanit i ka ofruar të dhënat e kërkuara vetëm për periudhën janar-nëntor 2018 për zonat kadastrale të Zhegocit, Poneshit dhe Bresalcit, mbi ndërrimin e pronarëve të parcelat e zonave kadastrale ku kalon traseja e autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë⁹.

Sipas Komunës së Gjilanit, gjatë kësaj periudhe janë proceduar 270 lëndë për ndërrim të pronarit, në kuadër të shitblerjeve, trashëgimisë, përfitimit në formë dhurate apo vendimeve nga gjykata.


Numri më i madh i ndërrimit të pronarëve të parcelave, gjatë kësaj periudhe, ka qenë në kategorinë e shitblerjes me gjithsej 131 lëndë të proceduara. Në këtë kategori, zona kadastrale e Bresalcit ka pasur më së shumti lëndë të proceduara me gjithsej 85 parcela të cilave iu janë ndërruar pronarët.

Në kategorinë e trashëgimisë janë proceduar gjithsej 95 lëndë, me zonën kadastrale të Bresalcit me numrin më të madh prej gjithsej 37 lëndësh.


⁹ Lëvizja FOL, përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, i ka kërkuar të njëjtat të dhëna edhe për vitet 2016 dhe 2017, mirëpo Komuna e Gjilanit nuk është treguar e gatshme që t'i ofrojë të njëjtat.

Në kategorinë e dhënies së pronës si dhuratë janë proceduar gjithsej 41 lëndë, ku numri më i madh ka rezultuar në zonën kadastrale të Bresalcit me gjithsej 22 lëndë.

Kategoria e fundit, kalimi i pronësisë nga një pronar në tjetrin me vendim të gjykatës, ka qenë kategoria me më së paku lëndë të proceduara, gjithsej 3, ku zona kadastrale e Bresalcit ka pasur numrin më të lartë të këtyre lëndëve me gjithsej 2.



Graf. 7. Ndarja sipas numrit e lëndëve të proceduara nga Komuna e Gjilanit mbi ndërrimin e pronarëve nga parcelat e zonave kadastrale Zhegoc, Ponesh, Bresalc të cilat përfshijnë periudhën janar-nëntor 2018.



Graf. 8. Ndarja sipas përqindjeve e lëndëve të proceduara nga Komuna e Gjilanit mbi ndërrimin e pronarëve nga parcelat e zonave kadastrale Zhegoc, Ponesh, Bresalc, të cilat përfshijnë periudhën janar-nëntor 2018.

Këto dy Komuna e kanë pasur të pamundur të kryejnë elaboratin e përveçëm të secilës nga lëndët lartpërmendura, ngase një proces i tillë, gjithnjë sipas tyre, do të ishte tejet i gjatë dhe do sillte një kosto të lartë financiare¹⁰.

¹⁰ Sipas zyrtarëve nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Komunën e Gjilanit, elaborati i vetëm një lëndë do të kërkonte kohë të gjatë dhe një kosto financiare prej rreth 50 euro.

Dëgjimet Publike

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, gjegjësisht Departamenti i Shpronësimit pranë kësaj ministrie, ka mbajtur dëgjime publike në zonat kadastrale të katër komunave të cilat janë prekur nga shpronësimi, sipas nenit 9 të Ligjit nr.03L/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Pjesëmarrja në këto dëgjime, bazuar në procesverbalet dhe listat e pjesëmarrjes të ofruara nga MMPH-ja, ka qenë tejet e ulët krahasuar me numrin e parcelave të prekura nga shpronësimi¹¹.

Në dëgjimin publik, të mbajtur në komunën e Gjilanit, nga 429 prona të prekura nga procesi i shpronësimit, kanë marrë pjesën vetëm rreth 80 të interesuar.

Në komunën e Novobërdës, gjatë dëgjimit publik, kanë qenë të pranishëm 93 persona. Megjithatë, nga parcelat e prekura nga shpronësimi në fshatin Parollovë, me gjithsej 55 parcela, vetëm një person ka qenë i pranishëm.

Gjithashtu edhe në komunën e Lipjanit pjesëmarrja në dëgjimet publike, në kuadër të procesit të shpronësimit ka qenë e ulët. Nga 279 parcela të prekura nga ky shpronësim në debatet publike kanë marrë pjesë vetëm 75 persona.

Bazuar në shifrat e lartpërmendura, duket që institucionet kanë dështuar në mënyrën dhe kohën e njoftimit të pronarëve të pronave dhe zotëruesve të interesit.

Nga ata persona, të cilët kanë marrë pjesë në dëgjimet me publikun, megjithatë janë shprehur shqetësime lidhur me procesin e shpronësimit në këto pika:

1. Mos informimin i pronarëve dhe zotëruesve të interesit me projektin në detaje;
2. Mos informimin rreth vijës së kalimit të trasesë;
3. Mospërputhjen në kategorizimin e parcelave, në mes të gjendjes në terren dhe elaboreteve;
4. Mos informimin mbi procesin, gjegjësisht mbi vijën tokësore e cila shpronësohet;
5. Dërgimin e njoftimeve dhe vendimeve me emër të gabuar tek pronarët ligjor të parcelave.

Mungesa e planifikimit të ndërtimit të autostradës, përfshirë mos përfundimin fillimisht të procesit të vlerësimit dhe shpronësimit të parcelave nga ku kalon ndërtimi i autostradës

¹¹ Procesverbalet nga dëgjimet publike për komunën e Gjilanit dhe atë të Lipjanit, veçanërisht në paraqitjen e problematikave nga banorët, kanë një ngjashmëri të madhe, sikur të njëjtat të ishin kopjuar nga një dëgjim publik në tjetrin.

Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë, si dhe mos informimi i duhur i pronarëve të pronave dhe zotëruesve të interesit, përbën një proces të mbyllur dhe jo mirë të menaxhuar.

Monitorimi i punimeve në terren

Lëvizja FOL ka monitoruar punimet në terren gjatë muajit Tetor 2018. Gjatë këtij monitorimi janë kontaktuar shtatë, nga tetë, kompanitë të cilat janë duke e ndërtuar autostradën¹². Ajo çfarë është vërejtur gjatë këtij monitorimi ka qenë vonesa në fillimin e punimeve sipas kushteve të paracaktuara me kontratë. Problematikat të cilat kanë shkaktuar vonesa në fillimin me kohë të punimeve, si dhe në përfundimin e disa pozicioneve sipas Planit për Menaxhimin e Kontratave, kanë qenë të llojit si: procesi i vonuar i shpronësimit, terreni i vështirë, probleme me deponimin e materialeve inerte, si dhe vonesa të shkaktuara nga reshjet atmosferike.

Sipas të gjitha kontratave të nënshkruara, kompanitë është dashur të fillojnë me punimet jo më vonë se pesë (5) ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Mirëpo, si rezultat i problematikave të lartcekura, kompanitë janë vonuar në fillimin e punimeve, duke shkaktuar vonesa sipas të dhënave të paraqitura në tabelën në vijim:

	Data e nënshkrimit të kontratës	Koha e fillimit të ekzekutimit të punimeve	Koha e reale e fillimit të ekzekutimit të punimeve
"GRANITI SH.P.K" - ISTOG Loti-I	12 shkurt 2018	Jo më vonë se 5 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës	28 maj 2018.
"GJOKA KONSTRUKSION sh.A" - TIRANË	14 shkurt 2018	Jo më vonë se 5 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.	21 maj 2018.
"NDERTIMTARI & GECI sh.p.k" - Prishtinë/ Tiranë	12 shkurt 2018	Jo më vonë se 5 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.	Maj 2018.

¹² Kompania "JOOS & KRASNIQI - BAZE sh.p.k & PE-VLA-KU sh.p.k" - Prishtine/Junik, e cila është duke i kryer punimet në Lotin VIII, nuk ka pranuar të kontaktojë në asnjë moment me Lëvizjen FOL.

"2 A Group & Alko Impex & 2 T & Exfish sh.p.k" - Prishtine/ Tirane	12 shkurt 2018	Jo më vonë se 5 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.	Korrik 2018.
"ESKAVATORI COMPANY sh.p.k & ABAD (ABISC)" - Ferizaj/ Bullgari	12 shkurt 2018	Jo më vonë se 5 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.	Fundi i muajit Prill 2018.
"Kag Asphalt Company & Beni Com sh.p.k" - Pizren/ Prishtine	13 shkurt 2018	Jo më vonë se 5 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.	Maj 2018.
"AL TRADE SALILLARI sh.p.k" - Prishtine/ Tirane	12 shkurt 2018	Jo më vonë se 5 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.	22 maj 2018.

Një problematikë tjetër e cila është shfaqur, gjatë vizitave në terren, ka qenë mungesa e Planit për Menaxhimin e Kontratave si nga ana e kompanive, ashtu edhe nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës e cila ka refuzuar që të njëjtin dokument t’ia ofrojë Lëvizjes FOL, edhe pse një dokument i tillë është kërkuar përmes ligjit për qasje në dokumentet publike.

Pa posedimin e Planit për Menaxhimin e Kontratave, monitorimi në terren, gjegjësisht vlerësimi i ekzekutimit të pozicioneve në trasenë e ndërtimit e autostradës, bëhet i pamundur.

Mospërputhje tjetër në mes të ekzekutimit të punimeve në terren dhe kushteve të kontratës është edhe koha e përfundimit të punimeve. Kompanitë të cilat janë duke kryer punimet deklarojnë se koha e përfundimit të punimeve llogaritet në ditë pune (mesatarja e kohëzgjatjes për përfundimin e punimeve është 30 muaj për të gjitha kompanitë), kurse kontrata e nënshkruar e specifikon vetëm kohëzgjatjen në muaj, pa specifikuar nëse këta muaj përfshijnë vetëm ditët e punës apo të tërë javën.

Komunikimi me institucionet

Lëvizja FOL ka hasur në pengesa gjatë komunikimit me institucionet e vendit, veçanërisht me institucionet të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë qenë të përfshira në procesin e prokurimit, si dhe shpronësimit dhe vlerësimit të parcelave për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë.

Në korrik të vitit 2018, Lëvizja FOL ka kërkuar disa nga dokumentet të cilat janë në posedim të Ministrisë së Infrastrukturës, megjithatë kjo ministri ka dështuar që një pjesë të këtyre dokumenteve t’ia ofrojë Lëvizjes FOL. Ndër dokumentet më të rëndësishme, për një monitorim të zbatimit të kontratës dhe zhvillimit të punimeve në terren, të cilat kjo ministri ka dështuar t’i ofrojë është edhe Plani i Menaxhimit të Kontratës. Vetëm disa nga dokumentet, ku përfshihen kontratat e nënshkuara në mes të ministrisë dhe Operatorëve Ekonomikë për ndërtimin e autostradës, janë ofruar edhe pse me një vonesë të konsiderueshme.

Ministria e Infrastrukturës, po ashtu, ka dështuar që të informojë Lëvizjen FOL nëse planifikimi i ndërtimit të autostradës ka qenë i paraparë me Planin e Prokurimit¹³.

Në kuadër të monitorimit, Lëvizja FOL ka kërkuar nga Ministria e Financave, gjegjësisht nga Departamenti i Tatimit në Pronë, shumë financiare përmes së cilave është paraparë të kompensohen pronarët dhe zotëruesit e interesit të pronave private të patundshme si rezultat i procesit të shpronësimit. Ministria e Financave, siç është cekur edhe më lart, ka kthyer përgjigje negative në kërkesën për qasje në dokumente publike, duke theksuar se është e pamundur të ofrohen të dhënat e kërkuara nga Lëvizja FOL, ngase të njëjtat përjashtohen nga e drejta e qasjes në dokumente, sipas Ligjit nr. 03/L-215, neni 12, paragrafi 1.2. mbi sigurinë publike dhe paragrafi 1.6. mbi privatësinë dhe interesat e tjerë legjitim privat. Lëvizja FOL, duke mos u pajtuar me përgjigjen refuzuese nga ana e Ministrisë së Financave, ka kërkuar nga e njëjta ministri që ta rishikojë vendimin e saj për të refuzuar të dhënat e kërkuara. Në përgjigjen e saj, Ministria e Financave thekson se kërkesa për rishqyrtim nga ana e Lëvizjes FOL është pranuar dhe se e njëjta është dërguar në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të marrë një opinion¹⁴.

Lëvizja FOL, gjithnjë në kuadër të pranimit të të dhënave mbi ndërtimin e autostradës, ka paraqitur ankesa pranë Institucionit të Avokatit të Popullit pas refuzimit të këtyre të

¹³ Ish drejtori i Zyrës së Prokurimit pranë MI-së është deklaruar se e ka pasur të pamundur të gjejë në arkiva Planin e Prokurimit pasi që ai nuk ka qenë pjesë e Zyrës së Prokurimit kur ka filluar planifikimi i ndërtimit të autostradës.

¹⁴ Deri në momentin përpilimit të këtij paragrafi të raportit, datë 10 janar 2019, Ministria e Financave nuk ka kthyer ndonjë përgjigje pranë Lëvizjes FOL.

dhënave nga ana e institucioneve publike. Më këtë rast Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Infrastrukturës që t'i ofrojë Lëvizjes FOL të dhënat e kërkuara si më lart, megjithatë të njëjtat ende nuk janë bërë publike nga kjo ministri¹⁵.

Një ankesë tjetër është paraqitur nga ana e Lëvizjes FOL, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me refuzimin e ofrimit të të dhënave nga Ministria e Financave. E njëjta ankesë është në pritje të një përgjigjeje nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, përderisa Ministria e Financave ende nuk ka kthyer përgjigje ndaj kërkesës së paraqitur nga Lëvizja FOL.

Mos ofrimi i të dhënave qenësore nga ana e institucioneve publike, në kuadër të ndërtimit të autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë, përbën një mbyllje të këtij procesi për qytetarin e Republikës së Kosovës, si dhe përbën shkelje të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore të cilat i mundësojnë qytetarëve të kenë qasje në të dhënat publike.

¹⁵ Ministria e Infrastrukturës, përveç një pjese të dokumenteve, nuk i ka ofruar Lëvizjes FOL ende Planin për Menaxhimin e Kontratës, si një ndër dokumentet më të rëndësishme të këtij procesi.

Përfundime

Kushtetuta e Republikës së Kosovës konsideron se shpenzimet publike ndër të tjera duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektivitetit, efikasitetit dhe transparencës. Kurse vet Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë është krijuar për tu siguruar që fondet publike shfrytëzohen drejtë dhe në mënyrë transparente. Megjithatë ndonëse kornizat ligjore janë rregulluar asisoj që të nxisin prezencën e transparencës dhe llogaridhënies institucionale, në praktikë këto dy elemente zbehen nga qenësia e tyre.

Monitorimi i kontratës së Autostradës Prishtinë-Gjilan është treguar i mbyllur për publikun. Mungesa e dokumenteve të prokurimit si plani i prokurimit dhe plani i menaxhimit e vështirësojnë procesin e monitorimit e në të njëjtën kohë lejojnë që ndërtimi i autostradës të vazhdojë me parregullsi.

Mungesa e bashkëpunimit nga institucionet si Ministria e Financave për të treguar shumat financiare përmes të cilave janë kompensuar pronarët dhe zotëruesit private të patundshmërive gjatë shpronësimit, ngrit dyshimet krahasuar edhe me të dhënat e marra për ndërrimet e shumta të pronarëve të tokave ku kalon traseja e autostradës.

Komunikimi që Lëvizja FOL ka pasur me institucione si Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Institucioni i Avokatit të Popullit, etj. tregon se është i domosdoshëm bashkëpunimi institucional drejt ngritjes së transparencës. Rekomandimet që janë dhënë nga Institucioni i Avokatit të Popullit nuk janë respektuar nga Ministria e Infrastrukturës, kurse ankesa ndaj Ministrisë së Financave ende nuk ka marrë një përgjigje.

Në tërë këtë proces, institucionet e prokurimit publik si KRPP dhe OShP kanë ende hapësirë të veprojnë për të rritur llogaridhënien e Autoritetit Kontraktues dhe Operatorëve Ekonomikë të përfshirë në këtë proces. Kjo kontratë që është nënshkruar dhe është në implementim e sipër ka ndërruar disa herë operatorët ekonomikë, kurse nuk është publikuar asnjëherë në uebfaqen e-prokurimi të KRPP.

Të gjitha problemet e lartpërmendura si dhe mungesa e dokumenteve që u shtjellua përgjatë raportit tregon për mbyllje të institucioneve dhe hezitim për t'i ofruar përgjigje publikut për shpenzimet financiare në kuadër të këtij projekti. Institucionet e vendit duhet të jenë të gatshme t'i ofrojnë të gjitha të dhënat mbi shpenzimet financiare, përfshirë këtu të dhënat mbi menaxhimin e kontratës, pasi që çmimit prej 88 milion euro për ndërtimin e së njëjtës autostradë me siguri do t'i shtohen edhe shumat financiare të vlerësimit/shpronësimit të pronës së paluajtshme.

FOL

“Andrea Gropa” nr.35, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 44 131 542 | www.levizjafol.org | info@levizjafol.org